

URDHËR
Nr. 734, datë 15.12.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, për nënshkrimin marrëveshjeve dhe ndjekjen e zbatimit të tyre, në emër të ministrisë përgjegjëse për arsimin me përfituesit e financimit apo përfaqësuesit ligjor të tij dhe institucionet publike të arsimit të lartë, ku studentët pranojnë për të kryer studimet dhe përfitojnë financim, sipas vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe udhëzimit nr. 30, datë 4.11.2022, “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit mbikëqyr realizimin e procedurave nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi